



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 15.05.2025

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.05.2025, pas shqyrtimit të Kërkesës me Nr. 02-070/05-0016065/25, të datës 06.05.2025, të paraqitur nga pala Fidan Fehmi Reçica nga fshati Miradi e Epërme, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 13, paragrafi 3, të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M

**Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016065/25, të datës 06.05.2025, për
lejimin e mjeteve financiare për shërim dhe trajtim shëndetësorë**

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016065/25, të datës 06.05.2025, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim dhe trajtim shëndetësorë, për palën Fidan Fehmi Reçica nga fshati Miradi e Epërme, i cili ka pësuar një fatkeqësi dhe është djegur 80% të sipërfaqes së trupit të tij, me Dg: 'Combustio termica, abrasio corneae', nga një materie kimike dhe i duhet trajtim i vazhdueshëm intenziv shëndetësorë, për arsye të natyrës së rëndë të lëndimeve trupore.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare nga nën - programi i Administratës së Shëndetësisë me Nr. 73011, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTORAT E ADMINISTRATËS

Nrfaq/Dr.stre. 42
Datë/Batem. 15.05.2025

PODARINA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 15.05.2025

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.05.2025, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 440, të datës 06.05.2025, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, mbështetur në Kërkesën me Nr. 11-346/06-0015698/25, e parashtruar në emër të banorëve të lagjes 029 nga përfaqësuesi Jashar Gashi dhe Kërkesën Nr. 11-346/06-0016093/25, të datës 06.05.2025 nga Kompania Kosovare për Distribucionin me Energji Elektrike Sh.A, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 6, paragrafi 2, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës Nr. 06/L-092, (Gazeta Zyrtare Nr. 10/2019), nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (n), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 440, të datës 06.05.2025 për lejin e vendosjes së Trafostacionit Elektrik me interes publik për komunitetin jo shumicë në lagjen 029 në Fushë-Kosovë

1. Për aprovimin e Propozimit me Nr. 440, të datës 06.05.2025 për caktimin e lokacionit dhe lejin e vendosjes së 'Trafostacionit Elektrik', në sipërfaqe të ndarë prej: S=26.9m², pjesë e Ngastres Kadastrale me Nr. P-72514036-01422-0 në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, nga sipërfaqja e përgjithshme e saj prej: S=1157 m², sipas numrit të lëndës Nr. 14-942-16451 të datës 08.05.2025, në funksion të dhënies në shfrytëzim për realizimin e interesit publik për banorët e komuniteteve jo shumicë në lagjen 029, në rrugën 'Fridjof Nansen' në Fushë-Kosovë.
2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës me destinim - infrastrukturë e komunës në të mirën e përgjithshme në pikën një të vendimit, është dhënia e pronës në shfrytëzim për realizimin e interesit publik për banorët e komuniteteve jo shumicë në lagjen 029 në rrugën 'Fridjof Nansen' në Fushë-Kosovë në sipërfaqen e caktuar.
3. Kryerja e procedurave tjera për ndarjen gjeodezike dhe skicimin e sipërfaqes prej gjithsej: 26.9m² për vendosjen e 'Trafostacionit Elektrik', pjesë e Ngastres Kadastrale me Nr. P-72514036-01422-0 në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, nga sipërfaqja e përgjithshme e

kësaj ngastre kadastrale prej: S=1157 m², e evidentuar sipas numrit të lëndës Nr. 14-942-16451, të datës 08.05.2025, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit e Pronës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.

4. Prona e cila jepet në shfrytëzim me destinim për vendosjen e 'Trafostacionit Elektrik', pas ndarjes së saj në sipërfaqen e cekur në pikën një të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastral të komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, KEDS, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së SHPM, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 23.05.2025

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 22.05.2025, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 469, të datës 13.05.2025, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 4, paragrafi 4, nën paragrafi 4.1, nenin 5, të Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale dhe kushteve për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera Nr. 83, të datës 06.06.2016 mori:

V E N D I M

Për shpalljen e veprimtarit dhe delegatit z. Nazmi Kelmendi “Qytetar nderi” i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025

1. Për shpalljen e veprimtarit, aktivistit, delegatit të Kuvendit të Kosovës dhe asambleistit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës z. Nazmi Avdi Kelmendi “Qytetar nderi” i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025, është i lindur me datën 04.11.1957, në lagjen e Nakaradës në qytetin e Fushë-Kosovës, shkollën fillore dhe të mesme e kreu në vendlindje në Fushë-Kosovë, Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës.
2. I lartë cekuri në pikën një të këtij vendimi është veprimtarë dhe aktivistë me kontribut të çmuar që në fëmijërinë e tij, kryetar i Organizatës së Rinisë në Gjimnazin e Fushë-Kosovës, Sekretar në Bashkësinë Lokale në vitet 1978-1987, në vitet e tetëdhjeta 80-ta i angazhuar në kulturë dhe sport, referent për mbrojtje dhe vetëmbrojtje në Fakultetin Teknik 1987-1990, delegat në Kuvendin e Kosovës që shpalli ‘Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës’, me datën 2 korrik 1990 dhe ‘Kushtetutën e Republikës së Kosovës’ me 7 shtator në Kaçanik, asamblesitë në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës në tre mandate zgjedhore 2007-2017 dhe i dekoruar me ‘Medaljen e Artë për Pavarësi’, nga Presidenti Historik i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova dhe shumë mirënjohje e falënderime tjera nga institucione të ndryshme të vendit.
3. Veprat dhe aktivitetit i tij me interes të përgjithshëm publik në fushën e sportit dhe kulturës, mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes së shoqërisë tonë dhe angazhimit të tij politikë në nivel vendi dhe nivel të komunës tonë, janë të njohura dhe të vlerësuara nga e gjithë shoqëria e vendit dhe komunës tonë.
4. z. Nazmi Avdi Kelmendi për titullin e dhënë nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025, mban të drejtat dhe privilegjet që i takojnë titullit “Qytetar nderi” sipas akteve ligjore dhe nënligjore.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Nazmi Kelmendi, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 23.05.2025

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.05.2025, pas shqyrtimit të Kërkesës me Nr. 02-070/05-0016650/25, të datës 12.05.2025, të paraqitur nga pala Feti Mehdi Breznica nga fshati Miradi e Epërme, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 13, paragrafi 3, të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016665/25, të datës 12.05.2025, për lejimin e mjeteve financiare për shërim dhe trajtim shëndetësorë

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016665/25, të datës 12.05.2025, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim dhe trajtim shëndetësorë, për palën Feti Mehdi Breznica nga fshati Miradi e Epërme, i cili vuan nga sëmundja e rëndë në fazën e metastazës, me Dg: 'Admcccatkim metastas cerolo' dhe i duhet trajtim i vazhdueshëm intenziv shëndetësorë, për arsye të natyrës së sëmundjes së rëndë.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare nga nën - programi i Administratës së Shëndetësisë me Nr. 73011, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

